VENDIM
Nr. 391, datë 9.6.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR SISTEMIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE BRENDA ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE CAKTIMIN SI NJËSI ZBATUESE TË BASHKISË KAMZË

(Ndryshuar me VKM nr. 664, datë 6.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 157 532 742 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, për sistemimin e hapësirave publike brenda zonës së re për zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 31 506 548 (tridhjetë e një milionë e pesëqind e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Kamzë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, në masën 124 643 653 (njëqind e njëzet e katër milionë e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për sistemimin e hapësirave publike brenda zonës së re për zhvillim, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Caktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, *sipas pikave 1, 2 dhe 2/1*, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama